



BULETINI METROLOGJIK

NR.1- 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT





Drejtoria Pergjithshme e Metrologjise

PËRMBAJTJA


Pasqyra e lëndës:

1.Vizioni dhe Misioni.....	3
2. Informacion mbi shërbimet e kalibrimit të ofruara nga Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale gjatë vitit 2024.....	4-5
3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, pjesë e Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP) Shqipëri.....	5-7
4. Pjesëmarrja e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në aktivitete ndërkombëtare.....	8-10
a. Pjesëmarrje në “EURAMET TC-Flow Summer School 2024, që u zhvillua në Institutin e Metrologjisë Çeke, CMI, Brno (Çeki).....	8
b. Pjesëmarrje në takimin vjetor EURAMET TC- Meeting 2024, Torino, Itali.....	9
c. Pjesëmarrje në takimin vjetor të Komitetit Teknik të Gjatësisë që u zhvillua në Beograd, Serbi, Tetor 2024.....	9
d. Pjesëmarrje në “Takimin vjetor të TC-Elektricitetit dhe Magnetizimit (TC-EM) 2024”, që u zhvillua në Paris, Francë.....	10
4.Promovim i aktiviteteve të DPM-së - Vizitë e Studentëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Tiranë, në laboratorët e DPM-së;.....	10-11
5.Marreveshje bashkepunimi.....	11



1.Vizioni

Zhvillimi i infrastrukturës bazë metrologjike në zonat prioritare për ekonominë dhe inovacionin në industri për të ruajtur aftësinë dhe për të siguruar gjurmueshmërinë metrologjike të matjeve. Plotësimi i kërkesave të Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (CIPM MRA) për të garantuar gjurmueshmërinë dhe njohjen zyrtare të matjeve të proceseve të prodhimit në nivelin më të lartë të cilësisë si mekanizëm për të hequr barrierat teknike në tregti për prodhuesit dhe eksportuesit vendas.



Misioni

Rregullimi i sistemit të njësisë së matjes, standardeve të matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimin e sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë.




2. INFORMACION MBI SHËRBIMET E KALIBRIMIT TË OFRUARA NGA DREJTORIA E METROLOGJISË SHKENCORE DHE INDUSTRIALE GJATË VITIT 2024.


Gjatë vitit 2024 nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), përmes laboratorëve kalibrues, ka realizuar shërbime kalibrimi për 1422 instrumente matëse, të shoqëruara me certifikatat e kalibrimit, prej të cilave 217 certifikata janë lëshuar me logo CIPM, MRA.

Referuar legjislacionit “Për Metrologjinë”, shërbimi i kalibrimit nuk përbën detyrim ligjor, por është fakultativ/vullnetar, me dëshirë dhe kryhet me kërkesën e përdoruesit të instrumentit matës.

Në varësi të tipit të instrumentit matës, shërbimi i kalibrimit të intrumenteve matëse është kryer në ambientet e laboratorëve kalibrues, në DPM, ose në vendpërdorimin e instrumentit (pranë subjektit). Më poshtë jepen disa fotografi gjatë procesit të kalibrimit të intrumenteve matëse.




Shërbimet e kalibrimit të intrumenteve matëse, të kryera sipas muajve, paraqiten në grafikun e mëposhtëm.




Grafiku nr.1: Numri i kalibrimeve të kryera, sipas muajve, gjatë vitit 2024

Gjithashtu në vazhdim tregohen në mënyrë grafike, tipet e instrumenteve matëse të kalibruara.



Grafiku nr.2: Tipet e instrumenteve matëse të kalibruar, gjatë vitit 2024

Referuar numrit total të kalibrimeve prej 1422 instrumente, nga të cilët 908 instrumente janë nga subjekte të jashtme (ose 64% e numrit total) dhe 514 instrumente janë të brendshme, instrumente të DPM (ose 36% e numrit total), paraqitur grafikisht si më poshtë.



Grafiku nr.3: Llojet e kalibrimeve, sipas kërkesave

3. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË, PJESË E PROGRAMIT GLOBAL PËR CILËSI DHE STANDARDE (GQSP SHQIPËRI)

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP Albania) me fokus “Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta - perimet”, e cila implementohet nga UNIDO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial dhe Sekretariati Zviceran Shtetëror për Punët Ekonomike (SECO).

Specialistë të sektorit të parapaketimeve të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë gjatë muajit tetor morën pjesë në një trajnim 3 ditor



ku morën njohuritë e nevojshme për akreditim me standardin ISO IEC 17065:2012.

Ky trajnim do ti sigurojë DPM-së një sistem certifikimi të njohur ndërkombëtarisht për produktet e paketuara duke siguruar që plotesojnë cilësinë mbarëkombëtare dhe standarde të sigurta.

Pse është kjo e rëndësishme?

- Rritja e besimit në produktet e çertifikuara: Akreditimi sipas ISO/IEC 17065 garanton që produktet e parapaketuara në Shqipëri të përputhen me standardet ndërkombëtare, duke krijuar besim midis konsumatorëve dhe rregullatorëve të tregut.
- Ulja e kostos dhe pavarësia: Me akreditimin e DPM-së, bizneset vendase mund të mbështeten në shërbimet kombëtare të certifikimit, duke ulur kostot dhe varësinë nga subjektet e huaja, ndërkohë që përmirësojnë aksesin në treg për prodhuesit shqiptarë.
- Nxitja e rritjes së eksporteve: Certifikimi i akredituar forcon aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur standardet e tregtisë globale, duke u dhënë bizneseve vendase një avantazh konkurrues në aksesin në tregjet ndërkombëtare.



Në kuadër të këtij projekti u realizua gjithashtu **Forumi i dytë Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet 2024**, në muajin nëntor, në partneritet me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe kishte si temë kryesore sfidat me të cilat përballen bizneset për të përmbushur standardet ndërkombëtare si dhe masat që po merren për forcimin e infrastrukturës së cilësisë, me qëllim rritjen e eksporteve dhe zgjerimin e hartës ku shkojnë prodhimet “Made in Albania”.

Ky forum shërbeu për të krijuar një komunikim konstruktiv midis prodhuesve, sipërmarrësve, institucioneve dhe ekspertëve, ku dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dha kontributin e saj si pjesë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë.





Programit Global i Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania ka publikuar broshurat:

- “Një rrugë drejt prosperitetit: avancimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-ve) përmes standardeve të cilësisë në Shqipëri”, e cila thekson rolin vendimtar të Infrastrukturës së Cilësisë (QI) në arritjen e tyre

<https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/sdg%20b.pdf>

- “Hapja e rrugës drejt BE-së për Shqipërinë” duke u fokusuar në ndihmën që GQSP po i jep Shqipërisë për Integrimin në BE, duke siguruar që infrastruktura e saj cilësore, praktikat e biznesit dhe mjedisi rregullator janë në përputhje me standardet e BE-së

<https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/EU%20Chapters%20brochure.pdf>

Më shumë informacion mbi aktivitetet mund të gjeni në rrjetet sociale të GQSP Albania.



4. Pjesëmarrja e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në Aktivitete Ndërkombëtare

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) është një institucion publik dhe i specializuar që zotëron aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme për t'u përdorur si referencë për të gjitha gjurmueshmëritë e matjeve në Shqipëri.

Për këtë arsye DPM-ja e sheh si faktor kryesor pjesëmarrjen e punonjësve të sajë në disa aktivitete ndërkombëtare, e cila shërben mjaft mirë dhe në rritjen e kapaciteteve menaxhuese e profesionale të administratës.

Disa nga aktivitetet ndërkombëtare në të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë siguroi pjesëmarrjen përmendim:

a) Pjesëmarrje në “EURAMET TC-Flow Summer School 2024, i zhvilluar në Institutin e Metrologjisë Çeke, CMI, Brno, Çeki.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë siguroi pjesëmarrjen në EURAMET TC-Flow Summer School 2024, në Institutin e Metrologjisë Çeke, CMI, Brno (Çeki) me prezencën e Znj. Zhaklina Domi, specialiste e Sektorit të Volumeve, Rrjedhjes dhe Kimisë.

Qëllimi i pjesëmarrjes ishte dhënia e mundësive specialistëve të rinj për të mësuar dhe përdorur me efikasitet matjet e vëllimit të lëngjeve, si dhe një përmbledhje hyrëse të standarteve aktuale ndërkombëtare të metrologjisë.

Gjatë takimit dy ditor, pjesëmarrësit u njohën me procedurat teknike të kalibrimit të volumeve

të vogla dhe të mëdha, matje praktike dhe llogaritje të pasigurive të matjeve për interval $> 1\text{ L}$ dhe $< 1\text{ L}$.



b) Pjesëmarrje në takimin vjetor EURAMET TC- Meeting 2024, Torino, Itali

Takimin vjetor i Komitetit Teknik të Masës dhe Njësive që rrjedhin prej saj dhe nënkomiteteve të masës, densitetit, presionit, forcës, gravitetit u zhvillua në datat 07 - 10 Tetor 2024, në INRiM, Torino, Itali. Gjatë takimit të N/Komitetit Teknik të Masës u bë prezantimi dhe përditësimi i statusit të projekteve të EURAMET-it. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë u përfaqësua në këtë aktivitet me Znj. Alma Jarani, Përgjegjëse e Sektorit të Masës dhe Densitetit dhe Z. Shukri Shehu, specialist në Sektorin e Matjeve Mekanike.

Gjatë takimit u diskutuan projektet për pjesëmarrje në krahasime ndërlaboratorike, hartimi i guidave të kalibrimit, projektet shkencore, krijimi i Infrastrukturës Digjitale të Cilësisë, Identifikimi i nevojave të laboratorëve kalibruar për trajnime në lidhje me Certifikatat Digjitale të Kalibrimit (DCC). Pjesë e takimit ishte edhe vizita në laboratorët e institutit.



c) Pjesëmarrje në takimin vjetor të Komitetit Teknik të Gjatësisë i zhvilluar në Beograd, Serbi

Takimi vjetor i Komitetit Teknik të Gjatësisë EURAMET TC-L u zhvillua në datat 21 - 23 Tetor 2024 në Beograd, Serbi.



Pjesëmarrja në këtë takim ishte prioritet pasi laborator i gjatësisë ka marrë pjesë vitin e kaluar në projektin e ndërkrahasimit EURAMET.L-S2.2.n01 për blloqe fundor, me të cilin synon deklarinimin e CMC-ve. Pjesëmarrja ishte shumë e vlefshme nga ana teknike si dhe për zhvillime të mëtejshme të laboratorit të gjatësisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë u përfaqësua në këtë aktivitet me Znj. Ejona Dara, specialiste e Sektorit të Matjeve Dimensionale e cila realizoi edhe një prezantim të DPM-së dhe laboratorit të gjatësisë.

d) Pjesëmarrje në “Takimin vjetor të TC-Elektricitetit dhe Magnetizimit (TC-EM) 2024”, i zhvilluar në Paris, Francë.

Takimin vjetor i “TC-Electricity and Magnetism (TC-EM) 2024” u zhvillua në LNE Paris, Francë.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë u përfaqësua në këtë aktivitet me Znj. Denada Dokuzi dhe Z. Fatos Shehu, specialistë pranë Sektorit të Matjeve Elektrike dhe Termometrisë.

Përfaqësuesit e DPM-së diskutuan me kolegët francezë dhe norvegjezë mundësinë për ndërkrahime të mundshme në lidhje me madhësitë DCV, ACV, DCI, ACI, R dhe Energjisë.

Gjithashtu u diskutuan tema të mundëshme për trajnime dhe workshop-e që mund të realizohen për vitin 2025 si dhe projektet më të rëndësishme në fushën e kërkimit dhe zhvillimit të realizuara gjatë vitit 2024.



4.PROMOVIM I AKTIVITETEVE TË DPM-SË

Në kuadër të kursit të trajnimit që u organizua nga Instituti i Ndërtimit për “Specialist të testimit të performancës së produkteve të ndërtimit”, ku morën pjesë specialistë që punojnë në fusha të ndryshme të ndërtimit, në laboratorët kalibruar të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë u organizua një vizitë ku të pranishmit shoqëruar nga drejtuesi didaktik i trajnimit Z. Afrim Çenga u njohën me shërbimet, proceset e matjeve dhe kalibrimet e pajisjeve që realizohen nga stafi i DPM -së.

Pjesëmarrësit u njohën me rëndësinë që ka DPM-ja në ekonominë e vendit, si dhe garancia





që jep ajo në kontrollet e duhura të pajisjeve dhe makinerive me të cilat prodhohen produktet nga prodhues të ndryshëm në Shqipëri.



4.PROMOVIM I AKTIVITETEVE TË DPM-SË

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlore gjatë muajit janar 2025 kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje synon kordinimin dhe dëshirën e mirë të dy institucioneve për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin me qëllim ofrimin për studentët e Universitetit “Ismail Qemali” praktika dhe trajnime sipas nevojave të tregut të punës.

Nëpërmjet praktikave dhe trajnimeve profesionale studentët do të krijojnë mundësi për të marrë eksperiencë pune, do zhvillojnë dhe zgjerojnë dijet e fituara në universitet si dhe do afirmohen dhe rritin mundësitë për punësim.

DPM- ja sipas aktiviteteve respektive do të ketë mundësinë e njohjes dhe vlerësimit të studentëve për praktika pune në të ardhmen.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT



Drejtoria Përgjithshme e Metrologjisë



Kontakt:



metrology@dpm.gov.al



<https://www.dpm.gov.al/>



<https://www.facebook.com/dpmGovAL/>



https://www.instagram.com/dpm_al

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km.8, Kashar, Tiranë, Shqipëri